

### Përmbledhje

Pas zhvillimeve më të ngadalshme të vitit 2012, TM1 2013 u karakterizua me një performancë dukshëm më të mirë krahasuar me vitin paraprak. Aktivizimi i aktivitetit tregtar, sidomos rritja e eksporteve paraqesin shenjat e para mbi përmirësimin e aktivitetit ekonomik gjatë TM1 2013. Gjithashtu, inkurajuese ishte edhe rritja prej afër 7 përqind e investimeve të huaja direkte. Përveç kësaj, pozitive për sektorin real të ekonomisë gjatë kësaj periudhe ishte edhe stabiliteti në financim të konsumit vendor nga dërgesat e emigrantëve që kanë shënuar rritje të theksuar prej 7.3 përqind. Gjithashtu, është inkurajuese për prospektet e prodhimit vendor trendi i rritjes së bizneseve të reja të regjistruara në përgjithësi me potencial për ndikime në punësim dhe rritje.

Zhvillimet në kuadër të çmimeve gjatë TM1 2013 u karakterizua me inflacion të moderuar. Rritja vjetore e çmimeve në mars të vitit 2013 arriti në 2.6 përqind, që vazhdon të jetë reflektim edhe i çmimeve të importit. Tregu i bonove të thesarit vazhdon të karakterizohet me normë të ulët të interesit si dhe ofertim të lartë nga bankat. Ndërmjetësimi financiar nga sistemi bankar vazhdoi trendin e ngjashëm me tremujorin e kaluar që në masë të madhe reflektohet nga aktiviteti kreditor. Rritja e kreditimit prej 3.8 përqind sipas bankave është si rezultat i rënies së kërkesës për kredi si dhe kritereve më konzervative në vlerësimin e kolatearit.

#### Ngjarjet kryesore të tremujorit I

**Rritja reale e PBB-së për vitin 2012** sipas vlerësimeve të BQK-së është 2.9 përqind. Komponenta e konsumit kontribuesi kryesor pozitiv, ndërsa neto eksportet kanë zvogëluar efektin negativ.

**Numri i bizneseve të reja** që u regjistruan në TM1 ka shënuar rritje rekorde prej 21.9 përqind në bazë vjetore. 3101 biznese të reja në TM1.

**Investimet e Huaja Direkte dhe Dërgesat e emigrantëve** shënuan rritje të lartë vjetore prej afër 7 përqind, përkatësisht 7.3 përqind.

Pritjet për periudhat në vazhdim janë se aktiviteti ekonomik vendor do të karakterizohet me trende të ngjashme që gradualisht pritet të përforcojnë stabiliten e përgjithshëm ekonomik. Këto pritje janë të ndërtuara bazuar në shëndetin e mirë të sistemin financiar por edhe përmirësimeve të theksuara në kuadër të sektorit të jashtëm që pritet të kenë implikime pozitive si për konsumin ashtu edhe për investimet private.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

### PËRMBLEDHJE-----i

### Zhvillimet në tregjet globale----- 03

### Ekonomia e Kosovës ----- 05

Sektori Real -----	05
Sektori Financiar -----	07
Kompanitë e Sigurimit -----	10
Fondet Pensionale -----	10
Institucionet Mikrofinanciare-----	11
Tregu i Kapitalit-----	11
Sektori i Jashtëm-----	11

### GRAFIKËT DHE TABELAT ----- 03

Figura 1. Çmimi i naftës “brent crude” -----	03
Figura 2. Çmimi i metaleve -----	04
Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit-----	04
Figura 4. Norma e këmbimit të euros -----	04
Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e financimit të ECB-së-----	05
Figura 6. Rritja reale e PBB-së -----	05
Figura 7. Indeksi i Çmimeve të Konsumit-----	06
Figura 8. Regjistri i bizneseve -----	06
Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	07
Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave dhe kredive-----	07
Figura 11. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	08
Figura 12. Mesatarja vjetore e normave të interesit-----	08
Figura 13. Normat mesatare të interesit për kredi për ndërmarrje-----	09
Figura 14. Treguesit e profitabilitetit-----	09
Figura 15. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë-----	09
Figura 16. Ankandet në letra me vlerë të Qeverisë -----	11
Figura 17. Pranimet e dërgesave të emigrantëve -----	12
Figura 18. Investimet e huaja direkte -----	12
Figura 19. Investimet e huaja direkte sipas investimit ekonomik -----	12
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	14

## SHKURTESAT:


ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit ( <i>angl. Capital Adequacy Ratio: CAR</i> )
CHF	Franku Zvicerran ( <i>angl. Swich Franc: CHF</i> )
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit ( <i>angl. Consumer Price Index: CPI</i> )
ECB	Banka Qendrore Evropiane ( <i>angl: European Central Bank: ECB</i> )
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro ( <i>angl. Euro currency</i> )
GBP	Poundi Britanik ( <i>angl. The Pound Sterling</i> )
IHD	Investimet e Huaja Direkte ( <i>angl. Foreign Direct Investments: FDI</i> )
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar ( <i>angl. International Monetary Fund: IMF</i> )
NPL	Kredive Jopërformuese ( <i>angl. Non-Performing Loans: NPL</i> )
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete ( <i>angl. Return on Average Assets: ROAA</i> )
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital ( <i>angl. Return on Average Equity: ROAE</i> )
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut ( <i>angl. Risk Weighted Assets: RWA</i> )
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USD	Dollari Amerikan ( <i>angl. United States Dollar</i> )

## Zhvillimet në Tregjet Globale

**Ekonomia globale** ka filluar të rishfaqë shenjat e rimëkëmbjes, megjithëse zhvillimet konsiderohen të ndryshueshme si rezultat i pasigurive në eurozonë. Parashikimet e FMN-së (IMF, WOE, 2013) për vitin 2013 janë kryesisht optimiste, ku rritja ekonomike reale në nivel global parashikohet që të arrijë në 3.3 përqind, krahasuar me vlerësimet prej 3.2 përqind në vitin 2012. Pritjet se ekonomia globale do të rikthejë momentumin e rritjes kryesisht mbështeten në përmirësimet e vazhdueshme të tregjeve financiare, në përmirësimin e sentimentit të bizneseve si dhe inflacionit relativisht stabil. Bartës të rritjes ekonomike globale konsiderohen vendet në zhvillim, ndërsa vendet e zhvilluara pritjet të kenë zhvillime më modeste. SHBA-të dhe Japonia pritjet të kenë normë pozitive të rritjes prej 1.9 përkatësisht 1.6 përqind, ndërsa eurozona pritjet të ballafaqohet me recesion të nxitur nga rënia ekonomike në Itali, Spanjë dhe Francë. Gjermania pritjet të neutralizojë zhvillimet negative në disa prej vendeve tjera pasi që parashikimet janë se ekonomia gjermane do të rritet me 0.6 përqind. Performanca më e ngadalshme në vendet e eurozonës pritjet të ketë efekte edhe në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore (EJL) përmes dobësimit të dërgesave të emigrantëve, eksporteve dhe investimeve të huaja direkte (IHD), duke ndikuar kështu në ngadalësimin e rritjes. Megjithatë, përveç Kroacisë, të gjitha vendet tjera të rajonit pritjet të përmbyllin vitin 2013 me normë pozitive të rritjes ekonomike (IMF, WEO, Prill 2013 dhe EC, PAC, 1/2013).

**Çmimet e naftës (brent crude)<sup>1</sup>** në nivel global, pas një periudhe me trend rritës, në shkurt të vitit 2013 shënuan pikë kthyesë dhe filluan të bien. Gjatë TM1 2013, çmimet e naftës u zvogëluan për 20.5 përqind, krahasuar me TM1 2012, duke arritur kështu çmimin prej 95.4 USD për fuqi (Figura 1).

Figura 1. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD



Burimi: Bloomberg (2013)


Rënia e çmimeve të naftës gjatë TM1 2013 u ndikua në masë të madhe nga rënia e kërkesës nga vendet e zhvilluara. Gjithashtu, pritjet për çmimet e naftës në periudhën afatshkurte dhe atë afatmesme janë se çmimi për barrel nuk do të tejkalojë vlerën prej 100 USD. Marrë parasysh se Kosova është e varur nga importi i naftës, rënia e çmimeve të naftës pritjet të ndikojë në çmimet e përgjithshme në vend duke ulur koston e prodhimit dhe transportit.

**Çmimet e Metaleve** gjatë TM1 2013 u karakterizuan me stabilitet që në masë të madhe reflekton zhvillimet ekonomike gjatë kësaj periudhe (Figura 2). Përjashtim bëjnë çmimet e bakrit dhe aluminit, të cilat krahasuar me TM4 2012 shënuan rënie. Duke marrë parasysh se metalet bazë përfaqësojnë mbi 50 përqind të gjithsej eksporteve të

<sup>1</sup> 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

Kosovës, si dhe prirjet e përgjithshme pozitive të këtyre produkteve, vlera e eksporteve të Kosovës pritet të rritet konform çmimeve.


Figura 2. Çmimet e metaleve, në EUR



Burimi: Bloomberg (2013)

**Çmimet e produkteve ushqimore** në nivel global, pas një trendi rritës përgjatë një periudhe relativisht të gjatë, në TM4 2012 dhe TM1 2013 filluan të zvogëlohen (Figura 3). Rënia e çmimeve gjatë kësaj periudhe është ndikuar kryesisht nga rënia e kërkesës globale, si dhe politikave stabilizuese në disa

Figura 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAOUN (2013)

nga vendet e zhvilluara. Rënia e indeksit të çmimeve ushqimore në përgjithësi, dhe atyre të drithërave në veçanti, pritet të ndikojë drejtpërsëdrejti në çmimet e këtyre produkteve në Kosovë. Kjo për arsye se niveli i

përgjithshëm i çmimeve në Kosovë ndikohet në masë të konsiderueshme nga çmimet e importit. Duke marrë parasysh se çmimet e drithërave dhe bukës përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shportës së konsumatorit në Kosovë, rënia e çmimeve të produkteve ushqimore pritet të rrisë fuqinë blerëse të konsumatorëve.

**Norma e këmbimit e Euros (EUR)** u vlerësua në mënyrë të vazhdueshme në dy tremujorët e fundit kundrejt tri valutave të mëdha në tregjet

Figura 4. Norma e këmbimit e Euros




Burimi: Bloomberg (2013)

ndërkombëtare, si Franku Zviceran (CHF), Sterlina Britanike (GBP) dhe Dollari Amerikan (USD) (Figura 4). Në TM1 2013, EUR më së shumti u vlerësua ndaj GBP me 5.4 përqind, krahasuar me tremujorin paraprak. Përkundër pasigurive që vazhdojnë ta karakterizojnë eurozonën, forcimi i EUR ndaj valutave ndërkombëtare në masë të madhe reflekton prirjet e investitorëve se eurozona do të përmirësojë prospektet ekonomike si rezultat i sukseseve të deritanishme të politikave për adresimin e borxhit publik të cilat ndikuan në uljen e rrezikut të perceptuar.

Në anën tjetër, kursi i këmbimit të EUR ndaj valutave të disa nga partnerët e rëndësishëm tregtar

të rajonit, u karakterizua me zhvlerësim. Vlera e EUR ndaj valutave të vendeve me kurs të këmbimit fleksibil, si Shqipëria dhe Serbia, u karakterizua me zhvlerëim, ndërsa duke marrë parasysh se Denari i Maqedonisë (DEN) përshkon kryesisht kurs fiks të këmbimit ndaj EUR, kursi i këmbimit ndryshoi lehtë në favor të vlerësimit të EUR ndaj DEN për 0.1 përqind në baza tremujore.

Figura 5. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e ECB-së



Burimi: Euribor (2013) dhe ECB (2013)


Pritjet se norma bazë e rifinancimit Bankës Qendrore Evropiane (*angl. European Central Bank: ECB*) nuk do të ndryshojë në muajt në vijim si dhe kushtet e likuiditetit të mjaftueshëm ndikuan që edhe Euribori të karakterizohet me luhatje të vogla. Normat 1-mujore, 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore u karakterizuan me rritje të lehtë dhe në mars të vitit 2013 qëndruan në 0.12 përqind, 0.21 përqind, 0.33 përqind dhe 0.55 përqind, respektivisht (Figura 5). Njëherit, norma bazë e rifinancimit e Bankës Qendrore Evropiane (*angl. European Central Bank: ECB*) vazhdon të qëndrojë në 0.75 përqind që nga korriku i vitit 2012, që paraqet edhe normën më të ulët historike të rifinancimit të ECB-së.

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Vlerësimet e fundit të BQK-së janë se norma reale e rritjes së PBB-së ka arritur në 2.9 përqind. Duke marrë parasysh se gjatë vitit 2012 janë rritur burimet e financimit të konsumit, një ndër bartësit kryesorë të rritjes ekonomike konsiderohet të jetë rritja e konsumit privat dhe publik.

Figura 6. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje




Burimi: ASK (2013), \*vlerësim i BQK-së

Burimet e financimit të cilat kanë ndikuar në rritjen e konsumit privat konsiderohet të kenë qënë rritja e kredive konsumuese, rritja e dërgesave të emigrantëve, rritja e shpenzimeve publike për paga dhe mëditje, rritja e transfereve publike për ndihmë sociale dhe pensione, ndërsa komponenta e shpenzimeve publike për mallra dhe shërbime e cila gjithashtu ka shënuar rritje ka ndikuar në rritje të konsumit publik. Përveç përmirësimeve në komponentën e konsumit, ishte edhe pozicioni i jashtëm i Kosovës që kishte përmirësime në kuadër të neto eksporteve, që drejtpërsëdrejti ndikojnë në rritje të PBB-së. Sa i përket komponentës së investimeve, përkundër faktit se investimet publike luajtën rol

kundërciklik, rënia e investimeve të huaja direkte (IHD) dhe transfereve kapitale në vend bëri që në përgjithësi investimet të jenë konsideruar me pozicion neutral gjatë vitin 2012. Pritjet për vitin 2013 janë se norma e rritjes në Kosovë do të jetë më e lartë e përkrahur nga stabiliteti financiar dhe pritjet se bankat do të zgjerojnë kreditimin, sidomos për ekonominë familjare. Gjatë vitit 2013 pritet stabilitet edhe në kuadër të dërgesave të emigrantëve. Sa i përket investimeve, pritjet janë se niveli i IHD-ve do të arrijë nivelin më të lartë historik si rezultat i privatizimit të ndërmarrjeve publike, duke përkrahur kështu fuqishëm komponentën e investimeve.

**Çmimet në Kosovë**, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimit të konsumit (*angl. Consumer Price Index: CPI*)

Figura 7. Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor




Burimi: ASK (2013)

gjatë TM1 2013 u karakterizua me inflacion të moderuar. Rritja vjetore e çmimeve në mars të vitit 2013 arriti në 2.6 përqind. Ndërsa, nga muaji shkurt në muajin mars 2013 niveli i çmimeve mbeti i pandryshuar (Figura 7).

Duke marrë parasysh se ekonomia e Kosovës është e bazuar kryesisht në importe, trendi i çmimeve në Kosovë në masë të madhe reflekton çmimet e produkteve të importit. Gjithashtu, një pjesë e

konsiderueshme e produkteve të importuara përbëhet nga produktet ushqimore, që rrjedhimisht reflekton edhe në çmimet e konsumit. Prandaj, mund të thuhet se rritja e çmimeve të importit (5.2 përqind mesatare vjetore) ka reflektuar edhe në rritjen e çmimeve të konsumit.

Figura 8. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2013)

Përkundër faktit se tremujori i parë i vitit zakonisht karakterizohet me aktivitet më të ulët në regjistrimin e bizneseve të reja, në TM1 2013 u regjistruan 3,101 biznese të reja duke shënuar kështu 21.9 përqind rritje vjetore (37.2 përqind rritje tremujore) (Figura 8). Në këtë periudhë edhe numri i bizneseve të mbyllura u rrit në 407 (21.9 përqind rritje tremujore, 86.7 përqind rritje vjetore). Si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë bizneseve të reja krahasuar me bizneset e mbyllura, raporti ndërmjet bizneseve të mbyllura dhe të hapura gjatë TM1 2013 u zvogëlua në 13.1 përqind (14.8 përqind në TM4 2012).

Struktura e ndërmarrjeve të reja të regjistruara sipas aktivitetit ekonomik vazhdon të dominohet nga bizneset tregtare, edhe pse pjesëmarrja e këtyre bizneseve po shënon rënie të vazhdueshme si rrjedhojë e rritjes së kategorive tjera biznesore (Figura 9).

Dy kategori tjera të bizneseve të reja, gjithnjë në rritje, janë edhe patundshmëria dhe ndërtimtaria, trende këto konform zhvillimeve të fundit në

Figura 9. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2013)

strukturën e ekonomisë së Kosovës. Zhvillim pozitiv në strukturën e bizneseve të reja vërehet në rritjen e bizneseve bujqësore, rritje kjo që pjesërisht mund të reflektojë edhe rritjen e përkrahjes përmes subvencioneve qeveritare. Rritja e bizneseve, e veçanërisht industrive përpunuese, patundshmërive dhe bizneseve bujqësore, pritet që gradualisht të ndikojë në strukturën e PBB-së si dhe në rritjen e kapaciteteve prodhuese në vend.


### Sektori financiar

Në TM1 të vitit 2013 asetet e sektorit bankar shënuan rritje më të lartë krahasuar me tremujorin paraprak si dhe me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e asetëve arriti në 2.83 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.6 përqind (6.8 përqind në TM1 dhe TM4 2012).

Norma vjetore e rritjes së kredive mbetet relativisht e njëjtë me tremujorin paraprak në 3.8 përqind, përderisa krahasuar me normën e rritjes vjetore në periudhën e njëjtë të vitit paraprak është dukshëm

më e ulët (13.5 përqind në TM1 2012) (Figura 10).

Figura 10. Trendi i rritjes së depozitave dhe kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Depozitat e sistemit bankar vazhduan trendin e tyre rritës. Në TM1 2013, vlera e depozitave arriti në 2.3 miliardë euro, duke shënuar normë vjetore të rritjes prej 8.7 përqind, ngjashëm me atë të vitit paraprak.


Në TM1 2013, ashtu si në TM4 2013, shkalla e rritjes së kredive për ekonomitë familjare vazhdoi të jetë më e lartë se ajo e ndërmarrjeve, ku kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind, ndërsa ato për ndërmarrje 4 përqind. Si pasojë e shkallës më të lartë të rritjes së kredive për ekonomitë familjare në raport me atë të ndërmarrjeve në tremujorët e fundit, pjesëmarrja e kredive të ekonomive familjare në gjithsej kreditë ka shënuar rritje të lehtë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (nga 30 përqind në TM1 2012 në 31 përqind në TM1 2013). Ndërsa, pjesëmarrja e kredive për ndërmarrje ka shënuar rënie nga 69 përqind në TM1 2012 në 67 përqind në TM1 2013.

Rezultatet e anketës së rregullt që BQK realizon me bankat në Kosovë përkrijnë me të dhënat për ngadalësim të rritjes së kreditimit krahasuar me vitin e kaluar. Në përgjithësi, bankat kanë raportuar rënie të kërkesës për kredi për tremujorin e parë të vitit, si



për sektorin e ndërmarrjeve, ashtu edhe për kreditë e ekonomive familjare. Bankat poashtu raportuan shtrëngim të standardeve për dhënie të kredive, kryesisht për ndërmarrjet e mëdha. Politika konservative e bankave në kontekst të shtrëngimit të standardeve raportohet të jetë kryesisht si rezultat i perceptimeve jo shumë optimiste për gjendjen e përgjithshme ekonomike si dhe shtrëngimit të kriterëve për vlerësim të kolateralit. Ndërsa, standardet për dhënie të kredive për ekonomitë familjare raportohen të kenë mbetur të njëjta.

Figura 11. Vlera e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në milionë euro




Burimi: BQK (2013)

Kreditë për ndërmarrje vazhdojnë të jenë të koncentruara në sektorin e tregtisë, i cili në fund të TM1 2013 përbënte 53 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Kreditë për këtë sektor shënuan rritje vjetore prej 5.6 përqind, duke arritur vlerën prej 643.5 milionë euro. Struktura e kredive për sa i përket sektorëve tjerë të ekonomisë mbetet e ngjashme me vitin e kaluar (Figura 11).

Kreditimi i bujqësisë, megjithëse shumë i ulët krahasuar me peshën e tij në Prodhimin e Brendshëm Bruto, ka shënuar rritjen vjetore pothuajse më të lartë të kreditimit. Në TM1 2013, kreditë për sektorin e bujqësisë u rritën për 13 përqind, duke

ngritur pjesëmarrjen e tyre në 3.8 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje (3.5 përqind në TM1 2012).

Figura 12. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje




Burimi: BQK (2013)

Kreditë për sektorin e prodhimitarisë kanë shënuar rënie në dy tremujorët e fundit. Në TM1 2013, rënia vjetore e kredive për prodhimitarinë ishte 8 përqind, që mund të jetë refleksion i ngadalësimit të përgjithshëm të aktivitetit ekonomik në vend dhe rajon. Mesatarja vjetore e normës së interesit për kredi ka vazhduar trendin e saj të lehtë rënës edhe në TM1 2013. Nga 13.9 përqind në mars 2012, mesatarja vjetore e interesit në kredi u zvogëlua në 13.3 përqind në mars 2013. Në anën tjetër, mesatarja vjetore e interesit në depozita shënoi ngritje të lehtë nga 3.5 përqind në 3.7 përqind. Si rezultat, dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe atyre për depozita është ngushtuar nga 10.5 pikë përqindje sa ishte në mars të vitit 2012 në 9.6 pikë përqindje në fund të marsit 2013 (Figura 12).

Rënia e mesatares vjetore të normës së interesit në kredi i atribuohet rënies së interesit në kredi për pothuajse të gjitha kategoritë. Norma mesatare e interesit për kreditë e konsumit për ekonomitë familjare në mars të vitit 2013 u zvogëlua në 13.1 përqind, krahasuar me 13.6 përqind në mars të vitit

2012. Gjithashtu, nëse analizohet norma mesatare e

Figura 13. Normat mesatare të interesit për kredi për ndërmarrjet, në përqindje



Burimi: BQK (2013)


interesit për kredi të ndërmarrjeve, në bazë të qëllimit të kredisë dhe maturitetit (Figura 13), mund të vërehet se ka pasur rënie në të gjitha kategoritë.

Kreditë me maturitet më të gjatë se një vit vërehet se janë karakterizuar me normë më të ulët të interesit ndër vite, përfshirë dhe periudhën TM1 2013. Ndërsa, sa i përket qëllimit të shfrytëzimit, kreditë për qëllime investive janë karakterizuar me normë më të ulët të interesit krahasuar me ato për qëllime tjera.

Performanca e sistemit bankar mbetet pozitive, dhe bazuar në analizimin e të dhënave të tremujorit të parë<sup>2</sup>, indikatorët kryesorë të performancës si Kthimi në Mesataren e Aseteve (ROAA) dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit (ROAE) kanë shënuar përmirësim të lehtë (Figura 14). Profiti neto i sistemit në TM1 2013 arriti në 6.2 milionë euro, që paraqet rënie krahasuar me TM1 2012 ku profiti ishte 7.4 milionë . Në fund të tremujorit të parë të vitit 2013, indikator i efikasitetit që matë raportin e shpenzimeve ndaj të hyrave të sistemit ishte 89

përqind, krahasuar me 90.5 përqind në fund të dhjetorit 2012.


Figura 14. Treguesit e profitabilitetit



\*Profiti i anualizuar i tremujorit të parë  
Burimi: BQK (2013)

Ndikim të konsiderueshëm në shpenzimet e bankave dhe, rrjedhimisht, në nivelin e profitit vazhdon të ketë cilësia e portofolit kreditor. Kreditë joperformuese shënuan rritje të lehtë në këtë tremujorë, duke

Figura 15. NPL dhe provizionet për humbje nga kreditë



Burimi: BQK (2013)

ngritur kështu raportin ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive në 7.6 përqind nga 7.5 përqind sa ishte në dhjetor 2012. Megjithatë, mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizionet për humjet potenciale nga kreditë vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm. Në Figurën 15 mund të shihet se mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizionet për humbje nga kreditë është rritur në

<sup>2</sup> Anualizimi i profitit është bërë duke shumëzuar profitin e tremujorit të parë me 12/3.

115.5 përqind në fund të marsit 2013, nga 112.7 përqind në dhjetor 2012.

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të qëndrojë mirë edhe për sa i përket pozitës së likuiditetit. Raporti i kredive ndaj depozitave në fund të marsit 2013 qëndroi në 78.6 përqind (77.4 përqind në dhjetor 2012), që është në nivel të përafërt me normën prej 80 përqind të rekomanduar nga BQK. Raporti i aseteve të gjera likuide (*ang: broad liquid asstes*) ndaj gjithsej aseteve në mars 2013 qëndroi në 31.3 përqind. Për më tepër, rezervat e bankave vazhdojnë të qëndrojnë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar nga BQK, duke siguruar kështu pozitë të favorshme likuiditeti.

Sistemi bankar në tërësi mbetet mirë i kapitalizuar, përkundër rënies së Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR), që kryesisht i atribuohet përshtatjes ndaj rregulloreve të reja të nxjerra nga Banka Qendrore. Në dhjetor të vitit 2012, hyri në fuqi rregullorja e re e Bankës Qendrore për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave. Ndryshimet në këtë rregullore, që kryesisht përfshijnë zbritjen e huave për personat e ndërlidhur nga kapitali i klasit të parë dhe përfshirjen e rrezikut operacional në kuadër të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut, u reflektuan në zvogëlimin e Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit të sistemit bankar. Bazuar në metodologjinë e specifikuar në rregulloren e re, CAR e sistemit bankar në dhjetor 2012 zbriti në 14.4 përqind, por që përsëri vazhdoi të jetë mbi normën minimale prej 12 përqind të kërkuar nga BQK.

### **Kompanitë e sigurimit**

Industria e sigurimeve përfaqëson një nga sektorët financiar që u karakterizua me rritje edhe gjatë TM1 2013 (rritje e aseteve 9.6 përqind në TM1 2013). Sa i përket aktivitetit të kompanive të sigurimit, vlera e primeve të pranuar deri në dhjetor 2012 është rritur më shpejtë deri në dhjetor 2012 (9.6 përqind rritje vjetore), ndërsa vlera e dëmeve të paguara është ngadalësuar në 1.1 përqind rritje vjetore (14.1 përqind rritje vjetore në 2011). Rritja e primeve të pranuar erdhi kryesisht si rezultat i rritjes së policave të pranuar në kufi për shkak të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit mes Kosovës dhe Serbisë.

### **Fondet pensionale**

Tremujori i parë i vitit 2013 u tregua i suksesshëm për performancën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK-së), duke marrë parasysh realizmin e kthimeve nga investimet prej 33 milionë euro. Njëherit, vlera e çmimit të aksionit u rrit për 4.3 përqind dhe arriti në 1.165 euro për aksion, që çoi edhe në një rritje të konsiderueshme të gjithsej aseteve nën menaxhim, përkatësisht në gjithsej 795 milionë euro (740 milionë euro në TM4 2012). Performanca pozitive erdhi si rezultat i zhvillimeve në tregjet golable, veçanërisht atyre në vendet e zhvilluara si SHBA dhe Japoni, ku edhe ishin të koncentruara mjetet e investuara të TKPK-së.

Sa i përket zhvillimeve në vend, vlenë të ceket se nga Janari i vitit 2013 TKPK-ja ka ndryshuar politikën e tërheqjes së pensioneve në faza, ku shuma minimale që mund të tërhiqet është rritur në 150 euro,

krahasuar me vlerën minimale prej 100 euro sa ishte më parë.

### Institucionet mikrofinanciare

Gjatë vitit 2012, performanca e Institucioneve Mikrofinanciare (IMF) shënoi rënie në të gjithë treguesit e raportuar. Kreditë e lëshuara nga IMF-të përcollën trendin rënës të vitit të kaluar, dhe gjithashtu në TM1 2013 pësuan rënie prej 9.2 përqind. Gjithsej vlera e kredive të lëshuara nga IMF-të në TM1 2013 arriti në 75.7 milionë euro. Përkundër normave të larta të kamatave në kreditë e IMF-ve (norma mesatare prej 23.5 përqind në TM1 2013), gjatë TM1 2013, pozicioni i të hyrave minus shpenzimeve rezultoi të jetë negativ prej 0.5 milionë euro.


### Tregu i Kapitalit

Sipas kalendarit për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vitin 2013 është paraparë rritje e frekuencës së ankandeve, ku gjithsej do të realizohen 21 ankande. Rrjedhimisht, krahasuar me vitin e kaluar ku mesatarisht realizoheshin 3 ankande në çdo tremujor, në vitin 2013 mesatarisht do të realizohen 5 ankande për tremujor. Në TM1 2013 u realizuan gjithsej 5 ankande, prej të cilave 3 ishin ankande të rregullta me shumë të ofruar prej 10 milionë euro dhe afat maturimi 91 ditë, ndërsa 2 ankande tjera me vlerë prej 20 dhe 24 milionë euro, me afat më të gjatë maturimi prej 182 ditë (Figura 16).

Nga këto shuma, 10.2 përqind e gjithsej ofertave ishin jo-konkurrese, ndërsa pjesa tjetër ishin konkurrese. Vlera e ofertave nga akterët primarë në TM1 2013 tejkaloi në çdo rund mesatarisht për 3 herë shumën e

ofruar nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave, normë kjo më e lartë se një tremujor më herët (2.1 herë në TM4 2012).

Figura 16. Ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë, në milionë euro



Vërejtje: Ankandet janë për shumtë e ofertuar për 91 ditë.  
(a) ankande për 192 ditë  
Burimi: BQK (2013)

Norma e interesit në bonot e thasarit gjatë TM1 2013 ka vazhduar të zvogëlohet edhe më tutje, krahasuar me normat e interesit gjatë vitit 2012 (Figura 16).


Në ankandin e muajit janar me vlerë prej 10 milionë euro, norma e interesit ishte 0.92 përqind me maturim prej 91 ditë, pasuar nga norma e interesit prej 1.44 përqind në ankandin vijues në po të njëjtin muaj, por me vlerë prej 20 milionë euro dhe maturim më të gjatë prej 182 ditë. Muaji shkurt dhe mars u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit prej 0.78 përkatësisht 0.65 përqind. Në muajin mars po ashtu u realizua edhe një emetim i ri me vlerë më të lartë prej 24 milionë euro, me normë më të lartë të interesit prej 1.05 përqind, por gjithashtu edhe me afat maturimi më të gjatë prej 182 ditë.

### **Sektori i Jashtëm**

Të dhënat e sektorit të tregtisë së jashtme tregojnë për rritje të deficitit tregtar në tremujorin e parë të vitit 2013, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në fund të muajit mars 2013, deficit

tregtar arriti vlerën 424 milionë euro, duke u rritur

Figura 17. Pranimet e dërgesave të emigrantëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)


për 6.3 përqind. Eksportet shënuan rritje prej 14.5 përqind krahasuar me TM1 2012. Rritja vjetore e importeve ishte më e ulët, 7.3 përqind, mirëpo përshkak të vlerës më të lartë të importeve në krahasim me eksportet bilanci tregtar shënoi përkeqësim. Vlera e eksporteve në fund të marsit 2013 arriti në 67.3 milionë euro, ndërsa vlera e importeve arriti në 491.3 milionë euro, që paraqet normë të mbulueshmërisë së importeve me eksporte prej 13.7 përqind.<sup>3</sup>

Komponent i rëndësishëm në bilancin e pagesave, i cili ndikon dukshëm në zvogëlimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse janë dërgesat e emigrantëve të cilat në fund të TM1 2013 arritën vlerën 127.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.3 përqind. Në Figurën 17 vërehet se dërgesat në tre kuartalet e fundit kanë shënuar shkallë dukshëm më të theksuar të rritjes vjetore, ku në TM1 2013 rritja qëndroi në nivel ndër më të lartët që nga viti 2010. Pas një periudhe të theksuar të rënies vjetore të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vitin 2012, në TM1 2013

<sup>3</sup> Të dhënat e tregtisë për periudhën shtator 2012 deri në janar 2013, të përpiluara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, nuk përfshijnë eksportin dhe importin e Energjisë Elektrike.

IHD-të janë karakterizuar me rritje të lehtë pozitive. (Figura 18). 2013, Vlera e IHD-ve arriti në 60.1


Figura 18. Investimet e huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

milionë euro, që paraqet rritje prej 6.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 19. Investimet e Huaja Direkte sipas aktivitetit ekonomik



Burimi: BQK (2013)

Duhet theksuar se përveç ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në eurozonë prej nga kryesisht vijnë IHD-të në Kosovë, rënia e vlerës së IHD-ve në periudhat e fundit gjithashtu u ndikua nga ngadalësimi i procesit të privatizimit. Sidoqoftë, pritjet janë se privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe rifillimi i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore do të ndikojë në vazhdimin e rritjes së nivelit të IHD-ve në tremujorët e ardhshëm të vitit 2013.

Struktura e investimeve të huaja direkte në TM1 2013 është, karakterizuar me rritjen e mëtutjeshme të pjesëmarrjes së sektorit të patundshmërive, njëherit sektori kryesor, në 37.6 përqind nga 30.5 përqind në TM1 2012 ndërsa sektorët si prodhimi e agrikultura kanë pësuar rënie të lehtë (Figura 19).

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	TM1-2013
<b>Sektori real 1/</b>							
PBB (në milionë euro)	3,379.4	3,710.7	4,077.0	4,136.5	4,486.0	5,021.0	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	4.4%	9.4%	-2.4%	3.5%	7.3%	2.5%	2.9%
Çmimet (ndryshimi vjetor)	10.5%	0.5%	0.1%	6.6%	3.6%	3.7%	2.6%
<b>Sektori fiskal 2/</b>							
Të hyrat (në milionë euro)	903.0	943.0	1,147.0	1,179.0	1,303.3	1,538.0	274.0
Shpenzimet (në milionë euro)	662.0	951.0	1,233.0	1,272.0	1,388.0	1,466.5	292.6
Bilanci, si përqindje e PBB-së	7.1	(0.2)	(2.1)	(2.2)	(1.9)	(1.4)	-
<b>Sektori financiar (në milionë euro) 3/</b>							
Asetet e korporatave financiare	2,941.9	3,370.3	4,005.0	4,440.5	4,732.0	5,289.3	5,360.2
prej të cilave: Bankat	1,435.0	1,808.3	2,204.6	2,455.0	2,649.7	2,829.3	2,835.7
Kredi	892.1	1,183.4	1,289.0	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,782.7
Depozita	1,143.1	1,444.1	1,744.8	1,936.9	2,104.0	2,279.1	2,269.4
Norma e interesit në kredi	14.1	13.8	14.1	14.3	13.9	12.9	12.6
Norma e interesit në depozita	4.0	4.4	4.0	3.4	3.6	3.7	3.5
Hendeku i normës së interesit	10.1	9.4	10.1	10.9	10.2	9.1	9.1
<b>Sektori i jashtëm (në milionë euro) 3/</b>							
<b>Bilanci i pagesave</b>							
Llogaria rrjedhëse	-214.0	-460.9	-374.2	-515.7	-658.5	-380.2	-13.4
prej të cilave: importi i mallrave	-1,530.1	-1,866.3	-1,828.9	-2,057.1	-2,383.9	-2,359.7	-460.9
prej të cilave: dërgesat e emigrantëve	588.5	608.7	585.7	584.3	584.8	605.1	127.8
Llogaria financiare	-5.8	288.5	109.0	275.9	376.8	130.3	-8.4
Investimet e huaj direkte në Kosovë	440.7	366.5	287.4	365.8	393.9	229.1	60.1
Investimet portfolio, net	-34.5	-109.9	-124.4	-49.2	-57.0	-184.9	-53.5
Investimet tjera, net	-108.0	75.2	-138.3	47.4	-5.6	369.2	-18.3
Pozicioni ndërkombëtar i Investimeve, net	1,278.9	941.2	524.4	444.6	133.9	248.8	405.9
Asetet	2,397.6	2,536.0	2,812.1	3,249.4	3,325.1	3,705.1	3,847.4
Detyrimet	1,118.6	1,594.9	2,287.8	2,804.8	3,191.2	3,456.3	3,441.4
<b>Borgji i jashtëm, gjithsej</b>	496.3	706.8	1,146.4	1,348.3	1,426.8	1,517.6	1,450.1
Borgji i jashtëm privat	496.3	706.8	837.1	1,022.4	1,106.7	1,116.2	1,052.2
Borgji i jashtëm publik	n/a	n/a	309.3	325.9	320.0	401.4	398.0

Burimi:

1/ ASK (2013)

2/ MF (2013)

3/ BQK (2013)

